

STATISTIKAT E TRANSPORTIT AJROR

Tremujori I, 2026


Në transportin ajror, gjatë tremujorit të parë 2026, kanë operuar 21 shoqëri ajrore të huaja. Në hapësirën ajrore shqiptare kanë fluturuar 74.329 avionë, nga të cilët 82,6 % të tyre e zë numri i mbikalimeve.

TAB. 1 DINAMIKA NË TRANSPORTIN AJROR

Periudha	TR I-2024	TR II-2024	TR III-2024	TR IV-2024	TR I-2025	TR II-2025	TR III-2025	TR IV-2025	TR I-2026
Numri i shoqërive ajrore	19	25	28	18	19	29	31	28	21
Numri i fluturimeve	13.334	18.600	21.572	15.072	13.332	18.458	22.938	15.396	12.898
Numri i mbikalimeve	41.733	84.316	111.141	67.570	51.814	91.615	116.985	73.861	61.431

Volumi i mallrave (duke përfshirë postën) të hyrë dhe të dalë nëpërmjet transportit ajror rezultoi 571 ton, nga të cilat 74,2 % janë mallra të hyrë dhe 25,8 % janë mallra të dalë. Krahasuar me tremujorin e parë 2025, volumi i mallrave paraqitet me rritje 3,8 %.


FIG. 1 VOLUMI I MALLRAVE DHE POSTËS NË TRANSPORTIN AJROR, NË TON



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Në tremujorin e parë 2026, kanë udhëtuar me linja ajrore 2.162.098 pasagjerë, nga 2.083.050 pasagjerë që kanë udhëtuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke u rritur me 3,8 %.

FIG. 2: TRANSPORTI AJROR I PASAGJERËVE




Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Eksportet/importet e mallrave me ajër

Volumi i mallrave të tregtuara (eksport dhe import) me ajër, në tremujorin e parë 2026, është 439 ton. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2025, ky tregues është rritur me 10,8 %.

Volumi i mallrave të importuara me ajër, në tremujorin e parë 2026, zë 0,02 % ndaj volumit gjithsej të mallrave të importuara.

FIG. 3: EKSPORT/IMPORT I MALLRAVE ME AJËR, NË TON



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, llogaritje INSTAT

Shënim për përdoruesit: Të dhënat e detajuara mujore dhe vjetore sipas grupeve janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Statistikat e Transportit Ajror](#), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Statistikat e Transportit Ajror](#)

Metodologjia

Publikimi i Statistikave të Transportit Ajror paraqet të dhëna tremujore mbi transportin ajror të mallrave dhe pasagjerëve, si edhe mbi eksportin dhe importin e mallrave përmes transportit ajror. Të dhënat janë administrative. Burimi kryesor i informacionit është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Përkufizime

Transport: Lëvizja e njerëzve dhe/ose mallrave, duke përdorur mjete të ndryshme transporti. Transporti mund të kryhet me mjete të transportit ajror.

Transport ajror: përfaqëson lëvizje e përgjithshme të planifikuar të mallrave dhe/ose pasagjerëve, të kryera nga shoqëritë ajrore.

Aeroport - Një zonë e caktuar e tokës ose ujit (përfshirë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet) të destinuara për t'u përdorur qoftë tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve dhe të hapur për operacionet tregtare të transportit ajror.

Linjë ajrore - Një ndërmarrje aviacioni që operon aeroplanët për qëllime tregtare që (i) kryen shërbime të planifikuara të transportit ajror, ose të dy, të cilat janë në dispozicion të publikut për transportin e pasagjerëve, postën, dhe / ose ngarkesa dhe (ii) është vërtetuar për qëllime të tilla nga autoriteti i aviacionit civil të shtetit në të cilin është themeluar.

Shërbimi ajror i pasagjerëve - Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar i kryer nga aeroplanët që transportojnë një ose më shumë pasagjerë të ardhura dhe çdo fluturim të listuar në oraret e publikuara si të hapura për pasagjerë.

Shërbimi ajror i mallrave dhe i postës - Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar, i kryer nga aeroplanët që mbajnë ngarkesa të ardhura (mallrave dhe postës), përveç pasagjerëve.

Numri i fluturimeve - Është numri i tretë fillestar i publikuar i caktuar nga operatori i transportit ajror në fluturim. Pasagjerët që përdorin një fluturim nga një aeroplan mund të udhëtojnë nën një sërë numrash të ndryshëm fluturimesh.

Pasagjerë të transportuar - Do të quhen të gjithë pasagjerët udhëtimi i të cilëve fillon ose mbaron në aeroportin raportues.

Mallrat e transportuar - Përfshijnë çdo ngarkesë e ngarkuar në avion ose e shkarkuar prej tij, duke përjashtuar bagazhet e pasagjerëve dhe postën.

Eksportet: Janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Importet: Janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Të dhënat e transportit ajror janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: [Politika e Revizionimit Statistikor](#).

Shpjegimi i simboleve

0 vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

- pa vlerë

(...) mungesë të dhënash